



Australian Government

Department of Health

Lehtësimi i kufizimeve

Australia me sukses ka 'rrafshuar kurbën' kurse numri i rasteve të reja me COVID-19 në vend për momentin është shumë i ulët. Tani mund të fillojmë të marrim hapa të kujdesshëm për të lehtësuar kufizimet që kanë ndihmuar në ndaljen e përhapjes së këtij virusi.

Gjithmonë ka pasur dallime se si është përhapur COVID-19 nëpër shtete dhe territore. Kabineti Nacional është pajtuar për një plan tre hapësh që gradualisht të hiqen kufizimet kryesore nga tani e deri në korrik e që merr parasysh këtë. Ky plan bazohet në këshillimin e ekspertëve të Komitetit Principal Australian për Mbrojtje Shëndetësore.

Sipas planit shtetet dhe territoret veprojnë sipas hapave me shpejtësi të ndryshme, varësisht nga rrethanat e tyre.

Siç edhe vazhdojmë të jemi një Australi COVIDSafe (e sigurt nga COVID), ne të gjithë akoma duhet të praktikojmë distancën fizike dhe higjienën e mirë. Më shumë se kurrë, është më rëndësi që njerëzit të qëndrojnë në shtëpi nëse nuk ndihen mirë – qoftë edhe kur janë vetëm pak të sëmurë.

Aplikacioni COVIDSafe gjithashtu do të ndihmon familjet, miqtë dhe komunitetet COVIDSafe (të sigurt nga COVID).

Suksesi ynë qëndron në COVIDSafe (të sigurt nga COVID) kurse lehtësimi i kufizimeve varet nga ne – si individë – duke marrë përgjegjësinë dhe duke i bërë këto sjellje pjesë të jetës tonë të përditshme. Kur do që dilni nga shtëpia mendoni se si do të mbani të sigurt veten, familjen, miqtë dhe shokët e punës.

Plani 3 hapësh i jep Australisë më shumë siguri në lidhje me atë se çka do të ndodh në muajt në vijim. Për secilën fushë më të gjërë të kufizimeve ka tre hapa kryesorë në mes asaj se ku jemi tani dhe ku duam të jemi.

Hapat e parë janë të kujdesshëm pasi që është me rëndësi të mos veprojmë shumë shpejt dhe të mos humbim bazën që kemi ndërtuar. Disa biznese do të nisin rë rihapen pasi të fillojmë të grumbullohen në shtëpi dhe në komunitet që grupe prej 10 veta. Hapat e parë do të ndihmojnë të rindërtohet ekonomia, dhe na jep më shumë mundësi për t'u lidhur me familjen dhe miqtë në mënyrë të drejpërdrejtë.

Hapat e dytë do të ndërtohen mbi këto grumbullime më të mëdha dhe në rihapen më të gjërë të bizneseve. Ashtu siç edhe bizneset do të ndërmarrin hapa për t'u siguruar se janë COVIDSafe (të sigurt nga COVID), të gjithë duhet të ndjehemi të sigurt dhe konfident për të bërë gjërat që na kanë munguar muajt e kaluar. Disa gjëra me rrezik të lartë akoma do të jenë të ndaluara.

Hapat e tretë do të fillojnë me adaptimin e plotë të mënyrave afatgjate të jetesës dhe punuarit me COVIDSafe (të sigurt nga COVID). Ky do të jetë 'normaliteti ynë i ri' përderisa virusi akoma paraqet një rrezik. Kufizimet do të minimizohen. Grumbullimi deri në 100 veta, udhëtimi në mes shteteve, rritja e sportit të komuniteteve, dhe mundësia për të udhëtuar në Zelandën e Re, akoma do të jenë sipas praktikave universale COVIDSafe (të sigurt nga COVID). Munden të mbeten disa kufizime, për gjëra siç është udhëtimi ndërkombëtarë dhe grumbullimi masiv.

Kabineti Nacional në mënyrë të rregullt do të mbikëqyrë përparimin tonë ashtu që të mund të vazhdojmë në mënyrë të sigurt.

Australia duhet të pret një rritje të rasteve apo një shpërthim të mundshëm me lehtësimin e kufizimeve. Ky plan nuk është për kthimin e jetëve tona në gjendjen para COVID-19, por për t'u mësuar me jetu me COVIDSafe (të sigurt nga COVID).

Nëse secili e bën këtë pjesë të punës, ne do të ndërtojmë një Australi COVIDSafe (të sigurt nga COVID), ku janë të mbrojtur jetët dhe mjetet e jetesës.